

30 DITË në AMA

SHQIP ANGLISHT

DËRGO ANKESË PËR RADIO DHE TELEVISIONE



Fq. 2

Lufta kundër piraterisë, ekipet e AMA-s nuk ndalen, bllokojnë platforma të paligjshme dhe identifikojnë servera piratë




Fq. 2

Tryeza për krijimin e Agjendës Digjitale, Krasniqi ftesë TikTok-ut të bashkëpunojë edhe me rregullatorët e tjerë të Ballkanit

Kontrollet e vazhdu-eshme të ekipeve të inspektimit në AMA dhe bashkëpunimi me subjektet e ligjshëm...

DËRGO ANKESË PËR TIKTOK



Fq. 3

Shkeljet ligjore: AMA vendos 46 gjoba gjatë periudhës Janar-Tetor 2024


AMA vendos 46 gjoba gjatë periudhës Janar-Tetor 2024. Masat janë marrë ndaj radiove, televizioneve dhe subjekteve kabllorë të autorizuar...

Certifikatë Mirënjohje për nismën "Fol Shqip"

Nisma "Fol Shqip" e nisur nga AMA në janar të vitit 2024, është vlerësuar me ikonën e Mirënjohjes në eventin e organizuar nga..



Fq. 2



Fq. 2

Takimi i 60-të i EPRA-s, diskutohen ndikimi i Inteligjencës Artificiale në media dhe lufta kundër përmbajtjeve të dëmshme

Kryetarja e AMA-s Znj. Armela Krasniqi, e cila mban dhe postin e nënkryetares së EPRA-s, ishte e pranishme në takimin e 60-të, të Platformës Evrop...

Tryeza për krijimin e Agjendës Digjitale, Krasniqi ftesë TikTok-ut të bashkëpunojë edhe me rregullatorët e tjerë të Ballkanit

Krijimi i një Agjende Digjitale për sigurinë e fëmijëve në Ballkanin Perëndimor ishte fokusi i konferencës së parë rajonale që u organizua në Tiranë nga Autoriteti i Mediave Audiovizive në bashkëpunim me Qendrën për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri (CRCA/ECPAT) dhe TikTok. Në tryezë merrnin pjesë drejtues të platformës TikTok, të rregullatorëve të Malit të Zi, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, ekspertë të fushës etj.



“Dua t’i shpreh mirënjohjen time AMA-s që u bë partneri ynë institucional në këtë projekt dhe në dialogun që kemi rreth sigurisë në fushën digjitale” u shpreh në këtë konferencë Z.Lukasz Gabler, Menaxher i Politikave Publike dhe Marrëdhënieve me Qeverinë CEE, TikTok. Ndërsa kryetarja e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi u shpreh se: “Pres që bashkëpunimi i suksesshëm i AMA-s me TikTok, të shërbejë si praktikë dhe për vendet e tjera të Ballkanit”. [Lexo më shumë](#)



Asambleja e 23-të plenare të MNRA, Idiaquez: Inkurajoj AMA-n për bashkë-punimin e ndërma-rrë me TikTok

Parimet e UNESCO-s për qeverisjen e platformave digjitale dhe zbatimin e tyre ka qenë kryefjalë e Asamblesë së 23-të plenare të Rrjetit Mesdhetar të Rregullatorëve (MNRA). Përfaqësuesi i UNESCO-s për Mbrojtjen e Lirisë Shprehjes dhe Mbrojtjes së Gazetarëve, Mikel Aguirre Idiaquez inkurajoi iniciativën e AMA-s për bashkëpunimin me platformat për të shmangur përmbajtjet e dëmshme dhe theksoi se mbështetja për këto iniciativa është e formalizuar në Udhëzuesin e UNESCO-s, që nxit bashkëpunimin dhe komunikimin midis rregullatorëve dhe platformave.

[Lexo më shumë](#)

Takimi i 60-të i EPRA-s, diskutohen ndikimi i Inteligjencës Artificiale në media dhe lufta kundër përmbajtjeve të dëmshme



Kryetarja e AMA-s Znj. Armela Krasniqi, e cila mban dhe postin e nënkryetares së EPRA-s, ishte e pranishme në takimin e 60-të, të Platformës Evropiane të Rregullatorëve Audiovizivë, EPRA. “Ndamë mes nesh njohuritë dhe eksperiencat mbi zbatimin e Aktit Evropian të Shërbimeve Digjitale, bashkëpunimin dhe përcaktimin nga sinjalizuesit e besuar, raportimin e gjuhës së urrejtjes online si dhe mënyrat e parandalimit të abuzimeve”- u shpreh Kryetarja e AMA-s.

[Lexo më shumë](#)

Certifikatë Mirënjohje për nismën "Fol shqip"

Nisma “Fol Shqip” e nisur nga AMA në janar të vitit 2024, është vlerësuar me ikonën e Mirënjohjes në eventin e organizuar nga RTV21 dhe emisioni “Fol Shqip Show”, me pjesëmarrjen e personaliteteve nga Shqipëria, Kosova dhe Diaspora. “Gjuha është identiteti dhe një ndër pasuritë më të çmuara që ne kemi, ndaj është detyrë e secilit prej nesh ta duam e ta mbrojmë”- tha Znj. Krasniqi. [Lexo më shumë](#)




Pirateria: Tryeza në Fier, Vlorë, Sarandë, Shkodër e Lezhë

Turi i tryezave të diskutimit për frenimin e piraterisë në internet në muaji tetor janë ndalur në qarkun e Fier, Vlorë, Sarandë, Shkodrës dhe Lezhës. “Pasi kemi kaluar fazën e konsultimit publik, ne do t’i çojmë propozimet tona për ndryshime ligjore në parlament”, u shpreh kryetarja e AMA-s Znj.Krasniqi teksa dëgjoi problematikën e subjekteve të ligjshëm, në këto qarqe.

[Lexo më shumë](#)

Lufta kundër piraterisë, ekipet e AMA-s nuk ndalen, bllokojnë platforma të paligjshme dhe identifikojnë servera piratë



Kontrollet e vazhdueshme të ekipeve të inspektimit në AMA dhe bashkëpunimi me subjektet e ligjshëm, kanë shfaqur të gjitha format që shkelësit e ligjit përdorin për të vjedhur përmbajtje audiovizive, për të cilat nuk kanë të drejta. Në qarqet Fier e Vlorë u konstatuan IPTV, të cilat aksesoheshin në rrjetin e brendshëm të IP-së publike, 109.236.45.14 me anë të portalit, <http://192.168.120.120:25461/c>. Ndërkaq në Sarandë u mbyllën dy platforma pirate ndërsa konstatuan një tjetër server OTT (OVER THE TOP), i arrit- shëm nga të gjithë rrjetet e internetit.

Edukimi mediatik, përdorimi i tepërt i celularit nga fëmijët nën 14 vjeç, rrezikon shëndetin


Studimet tregojnë se, përdorimi i tepërt i telefonave nga fëmijët nën 14 vjeç, si dhe përdorimi i rrjeteve sociale prej tyre, ka shtuar edhe shtimin e rasteve të depresionit dhe ankthit në këto moshë. Për këto arsye është i rëndësishëm Prindërimi Digjital, një koncept i ri në lidhje me prindërimin, por fort i përshtatshëm për kohën në të cilën jetojmë. [Lexo më shumë](#)



Transparenca AMA-TikTok, hiqen nga platforma të videot e raportuara për pirateri

Nga fillimi i bashkëpunimit me platformën TikTok, janë shënuar 995 video të raportuara për pirateri dhe po kaq të hequra nga platforma. Deri tani janë shqyrtuar dhe marrë masat për 516 ankesa të ardhura në AMA ndërsa 178 janë vlerësuar në shkelje të ligjit. Nga këto, 171 video/audio janë hequr nga platforma dhe 7 të tjera janë në shqyrtim. [Lexo më shumë](#)

[Lexo më shumë](#)



Shkeljet ligjore: AMA vendos 46 gjopa gjatë periudhës Janar-Tetor 2024

AMA vendos 46 gjopa gjatë periudhës Janar-Tetor 2024. Masat janë marrë ndaj radiove, televizioneve dhe subjekteve kabllorë të autorizuar, për shkelje të ndryshme ligjore. Nga monitorimi i përmbajtjeve, apo nga shqyrtimi i ankesave të mbërritura në Këshillin e Ankesave, gjatë kësaj periudhe janë konstatuar mes të tjerash, transmetime që nxisin urrejtjen mes shtetasve, që cenojnë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut, që nxisin ose justifikojnë dhunën etj. [Lexo më shumë](#)